



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.268/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.T.“FER-PETROLL”, me seli në fshatin Tërstenik, Komuna e Glllogocit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hasan Haxhaj, avokat në Glllogoc, kundër debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, rruga “Luan Haradinaj” nr.133, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.138/2023 të datës 01.08.2023, me datë 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kreditorit N.T.FER-PETROLL, me seli në fshatin Tërstenik, Komuna e Glllogocit, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.138/2023 i datës 01.08.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.138/2023 të datës 01.08.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.1/23 të datës 05.01.2023, të përmbaruesit privat Blerim Baloku, dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që kreditorit t’i njihen shpenzimet e procedurës apo i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori N.T.“FER-PETROLL”, me seli në fshatin Tërstenik, Komuna e Gillogocit, me datë 05.01.2023 ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit të përmbartimit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, rruga “Luan Haradinaj” nr.133, në bazë të dokumenti të besueshëm faturës nr.1094 të datës 30.11.2022, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 24,692.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi privat Blerim Baloku, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.1/2023 të datës 05.01.2023, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori ka paraqitur prapësime të cilin nuk e konteston borxhin dhe lartësinë e tij, mirëpo deklaron se është i pamundur ekzekutimi i detyrimit në këtë periudhë kohore për shkak të situatës së krijuar me buxhetin e Kosovës, pasi që debitori është institucion i varur nga ndarët buxhetore te pushtetit ekzekutiv dhe ka shprehur gatishmëri që ta përmbush vullnetarisht detyrimin në momentin kur do të alukohet buxheti për vitin 2023 dhe të bëhet shpërndarja e tij për KGJK , i propozon gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit.

Ndërsa përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me të cilën deklaron se debitori nuk e konteston obligimin e tij për pagesë dhe vonesën e tij në përmbushje të detyrimit, mirëpo ka provuar të tregoj se i njëjti është fajtor për mospërmbushje në kohë të faturës. I propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.1/2023 dt.05.01.2023 dhe të detyroj debitorin që t,ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimin në shumën prej 312.00€.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.138/2023 të datës 01.08.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.1/23 të datës 05.01.2023, të përmbartuesit privat Blerim Baloku, dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar së pas shqyrtimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave të lëndës ka gjetur se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozim për përmbartim, i lejuar me urdhrin përmbartimor P.nr.01/2023 të datës 05.01.2023 në shumën prej 24,692.00 Euro, është përmbushur në tërësi nga ana e debitorit. Andaj gjykaat vlerësoi se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 55 par.4 të LPP-së, përfundoi procedurën në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata e Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës, për arsye se aktvendimi i ankimuar për këtë pjesë është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së. Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Në këtë kontekst dhe në shiqim të shkresave të lëndës, përkatësisht propozimin për përmbarim, kjo gjykatë vlerëson se kreditori përpos kërkesës për përmbushje të borxhit kryesor ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka vendosur për përfundim të procedurës për borxhin kryesor por jo edhe për çështjen e shpenzimeve procedurale. Në lidhje me këtë rast neni 465 paragrafi 3 të LPK-së, parasheh që: *“Kur anulohet vendimi, kundër të cilit është paraqitur mjeti i goditjes dhe lënda kthehet për rigjykim, do të lihet që për shpenzimet lidhur me procedurën sipas mjetit të goditjes të vendoset me vendimin përfundimtar”* e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për shpenzimet procedurale në aktvendimin e ankimuar.

Andaj me qëllim të vendosjes për shpenzimet procedurale të cilat i ka kërkuar kreditori përmes propozimit për përmbarim por të cilat nuk janë precizuar dhe për te cilat nuk ka vendosur gjykata e shkallës së parë, e njëjta udhëzohet që konform nenit 463 paragrafi 2 të LPK-së, i cili parasheh që: *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*, të kërkoj nga pala kreditore precizimin e shpenzimeve procedurale, arsye kjo për te cilën kjo gjykate vendosi që aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rigjykim dhe rivendosje.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.268/2024 me datë 08.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha